

**KOMPANIA RAJONALE E UJËSJELLËSIT
SH. A.**



Mars 2020

1. PËRMBAJTJA

1. Përmbajtja	2
Hyrje.....	3
2. Raporti i Kryesuesit të Bordit të Drejtorëve.....	3
• Aktivitetet dhe performanca e ndërmarrjes.....	4
o <i>Aktivitetet kryesore të ndërmarrja gjatë vitit 2019</i>	4
o <i>Pasqyra e performancës operative dhe financiare në krahasim me vitet paraprake dhe Plan të Biznesit</i>	9
o <i>Një pasqyre e të priturve për vitin 2020</i>	12
• Informacione lidhur me kapitalin dhe dividenden.....	13
o <i>Kreditë e rëndësishme të nënshkuara apo paguara gjatë vitit</i>	13
o <i>Plani i Investimet e bëra gjatë vitit 2019</i>	13
o <i>Dividendët e paguara gjatë vitit 2019</i>	14
• Të dhëna për Drejtorët jo-ekzekutiv.....	14
o <i>Bordi i Drejtorëve në KRU “Hidrodrini” Sh. A. Pejë ka këtë përbërje</i>	14
o <i>Kompensimet, shpenzimet dhe pagesat për shërbimet e Ndërmarrjes për vitin 2019</i>	14
o <i>Numri dhe pjesëmarrja e drejtorëve në takimet e rregullta të BtD, gjatë vitit 2019</i>	15
o <i>Komisioni i Auditimit në KRU “Hidrodrini” Sh. A. Pejë ka këtë përbërje:</i>	17
• Informacione të tjera	19
o <i>Kërkesat për likuidimin e Ndërmarrjeve shoqërore për vitin 2019</i>	19
o <i>Informacione tjera, ashtu siç parashihet në LNP dhe statutin e NP-ve</i>	19
3. Raporti i Zyrtarit Kryesor Ekzekutiv.....	19
• Ngjarjet kryesore të vitit 2019	19
• Pasqyrën e performances operative dhe financiare si dhe rezultatet e indikatorëve kyç të performances.....	27
o <i>Prodhimi i ujit</i>	27
o <i>Kualiteti i ujit</i>	28
o <i>Çështjet Ligjore</i>	28
• Pasqyra e performances financiare dhe rezultatet	28
• Progresi me planin e Biznesit	30
• Perspektiva për vitin e ardhshëm	32
• Rreziqet e të ardhmes së korporatës.....	32

HYRJE

Qeveria e Republikës së Kosovës, është pronare e shoqërive aksionare me kapital publik. Kompania e Ujësjesit Rajonal "Hidrodrini" SH. A., themelohet në zbatim të Ligjit Nr. 03/L- 087, "Mbi Ndërmarrjet Publike" dhe Ligjit Nr. 02/L-123, "Për Shoqëritë Tregtare", të Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 03/74, të datës 14.07.2009 dhe të Vendimit të Komisionit të Ministrave Nr. 218/1, të datës 30.09.2009. Shoqëria është trashëgimtare e Ndërmarrjes Publike, Kompania e Ujësjesit Rajonal "Hidrodrini" Holding SH. A

Numri popullatës që Kompania Rajonale, "HIDRODRINI" iu kryen shërbime me ujë të pijes vlerësohet rreth 187.000 banor, gjegjësisht me 987Km gjatesi të rrjetit të ujesjellesit ndërsa shërbimet e ujërave të zeza ~ 60,000 banor, gjegjësidht me 162 Km gjatësi të rrjetit të ujerave te zeza. Kapaciteti momental prodhues sillet 25.024.278 m³/vjet.

Kompania është dhe do të mbetet ofruer profesional i furnizimit me ujë të pijshëm të kualitetit të lart dhe të shërbimeve të kanalizimit. Prodhimi, shitja e ujit, shërbimet e kanalizimit dhe shërbimet tjera janë detyrat kryesore të kompanisë.

Qendra e kompanisë është në Pejë, në strukturën e vetë ka 5 njësi të biznesit në Pejë, Istog, Klinë, Junik dhe Deçan.

Bordi i Drejtoreve i përzgjedhur nga Qeveria e Republikës së Kosovës, është organ i pavarur dhe bënë drejtimin dhe mbikëqyrjen e biznesit të kompanisë. Staf i menaxhues i kompanisë organizon punën, kryen udhëheqjen efektive të veprimtarisë dhe stafit.

Raporti Vjetor i KRU " Hidrodrini" Sh. A. - Pejë për vitin 2019 është përpiluar duke u bazuar në dispozitën e nenit 31.3 të Ligjit Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, dispozitën 28.6 të Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Korporatave të Ndërmarrjeve Publike dhe Udhëzuesin për përpilimin e Raportit Vjetor të Ndërmarrjeve Publike të lëshuar nga Njësia për Politikë dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike .

2. RAPORTI I KRYESUESIT TË BORDIT TË DREJTORËVE

Bordi i Drejtorëve të NP-së ushtron mbikëqyrje të vazhdueshme dhe rigoroze, në veçanti, të veprimtarin e zyrtarëve të NP-së, gjithnjë në përputhje me të drejtat dhe përgjegjësit e Bordit.

- **Aktivitetet dhe performanca e ndërmarrjes**

- ***Aktivitetet kryesore të ndërmarrja gjatë vitit 2019***

- ✓ Përkushtim, angazhim më i madhë i punëtorëve në teren.
- ✓ Matje korrekte të konsumit.
- ✓ Reduktimi i humbjeve teknike dhe administrative.
- ✓ Instalim të ujëmatësve në zonat dhe caktimi dhe monitorimi i zonave DMA.
- ✓ Riparim të rrjedhjeve vizuale.
- ✓ Reduktim të sasisë së ujit në zona të caktuara (presioni), menaxhimi i presionit të ujitë
- ✓ Identifikim të shfrytëzuesve të pa autorizuar (vjedhja e ujit).
- ✓ Rritje e numrit të konsumatorëve.
- ✓ Rritjen e investimeve në zevendesim e gypave të vjetër.
- ✓ Rritja e shkallës së arkëtimit.
- ✓ Hartimi i listave me emra të borxhliëve dhe procesimi me Përmbartues.
- ✓ Vazhdimi i kontratës me PTK, dhe kontrata të reja me shërbime që ofrojnë këto shërbime të pagesave për pagesat e faturave në pikat e tyre.
- ✓ Hartimi i listës investuese prioritare për donatorët potencial.
- ✓ Ngritja e efikasitetit të stafit.
- ✓ Sistemimi i punëtorëve.
- ✓ Përfundimi i zbatimit të Ligjit dhe Rregulloresve të brendshme.

Gjatë kësaj periudhe Bordi i Drejtorëve dhe Komisioni i Auditimit në mbledhjet e rregullta të mbajtura gjatë vitit 2019 kanë marrë vendime dhe kanë dhënë rekomandime apo sygjerime për zgjidhjen çështjeve të ndryshme të cilat kanë pasur ndikim pozitiv në performancën e Kompanisë, si për :

- Rritjen e arkëtimit të borxheve;
- Zvogëlimin e humbjeve të ujit;
- Zvogëlimin e shpenzimeve;
- Furnizimin me ujë të konsumatorëve 24 h/në ditë;
- Kualitetin dhe sasinë e ujit të prodhuar;
- Ndërmarrjen e aktiviteteve për rritjen e faturimit si dhe
- Reduktimin e lidhjeve të pa autorizuara.

Bordi i Drejtorëve gjatë vitit 2019 ka përcjell edhe ecurin e implementimit të Projekteve :

- Investimet nga Banka Gjermane, Zyra Zvicerane dhe Qeveria e Republikës së Kosovës për Ndërtimin e Impiantit për Trajtimin e Ujërave të Zeza Bordi i Drejtorëve është njoftuar me punën e dy Konsulencave AMC Sachsen Wasser (Leipzig) dhe IC Dahlem Ber.(Essen) duke filluar nga hartimi i Raporteve fillestare, projekti është në Implementim dhe do të zgjasë deri në fund të vitit 2021.
- Investimet nga Zyra Zvicerane në bashkëpunim me Qeverinë e Republikës së Kosovës
(Rehabilitimi i ujësjellësve rural dhe pas përfundimit të projekteve, integrimi i tyre në kuadër të KRU “ Hidrodrini” Sh.A. Pejë
- Projektin e financuar nga Banka Gjermane faza V në vlerë prej 8 mil. € për Pejë, Gjakovë dhe Prizren (rehabilitimi i kanaleve të ujërave të zeza dhe inqizimi i rrjetit) i cili ka filluar në fund të vitit 2019 dhe i cili është në Implementim.
- Projekti i financuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës - Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor (Rehabilitimi i ujësjellësit të fshatit Strelc) në vazhdimësi.

Në mbledhjet e Bordit të Drejtorëve të KRU “Hidrodrini“ Sh. A. Pejë, ndër të tjera janë shqyrtuar dhe janë aprovuar edhe këto dokumente :

- Raporti Vjetor i Performancës të KRU “ Hidrodrini” Sh. A. Pejë për vitin 2018 (Vendimi Nr. Prot.06/03/02/2019 dt.04/03/2019)
- Pasqyrat Financiare të KRU “ Hidrodrini” Sh. A. Pejë për vitin 2018 (Vendimi Nr.prot.6/02/02/2019 04.03.2019)
- Raporti Vjetor mbi Kënaqshmërinë e Konsumatorëve të KRU “Hidrodrini” Sh. A. Pejë për vitin 2018 (Vendimi Nr.prot.9/02/03/2019 dt.29.03.2019).
- Raporti i Auditorit të Jashtëm për Pasqyrat Financiare të KRU “ Hidrodrini” Sh.A. Pejë për vitin 2018 dhe Letër Menaxhmenti (Vendimi Nr.prot.12//04/04/2019 dt.26.04.2019)
- Raportet Operative dhe Financiare mujore dhe TM ;
- Raportet mbi realizimin e Planit të Biznesit sipas dinamikës për TM ;
- Raportet mbi Kënaqshmërinë e Konsumatorëve për TM ;
- Vetëvlerësimi i Bordit të Drejtorëve (Vendimi Nr.prot.124 dt.29.03.2019)

- Vlerësimi i performances së KRU “ Hidrodrini” Sh. A. (Vendimi Nr.prot.187 dt.27.05.2019)
- Kërkesa Nr.prot.165 të dt.31.05.2019 e parashtruar nga ana e Kryeshefit Ekzekutiv të Kompanisë që me rastin e Festës së Bajramit të Madh të gjithë punëtorëve të KRU “Hidrodrini“ Sh. A. Pejë të ju ndahen mjete financiare në vlerë bruto prej 100 € për secilin punëtor, të cilat mjete do të shpërndahen bashkë me pagën e muajit Prill - 2019.(Vendimi Nr.prot.25/02/05/2019 dt.31.05.2019)
- Kërkesa Nr.prot.425 dt.08.08.2019 e parashtruar nga ana e Kryeshefit Ekzekutiv të Kompanisë që me rastin e Festës së Bajramit të Vogël të gjithë punëtorëve të KRU “ Hidrodrini “ Sh. A. Pejë të ju ndahen mjete financiare në vlerë bruto prej 50 € për secilin punëtor, të cilat mjete do të shpërndahen në llogarinë bankare të secilit punëtor. (Vendimi nr.prot.27/2019 dt.08.08.2019)
- Autorizimin e Zyrtarit të Lartë Financiar që t’i drejtohet Bankës Qendrore të Kosovës me një kërkesë me shkrim për lejimin e pagesës së faturave me *e-banking* për konsumatorët e KRU “Hidrodrini” Sh. A. Pejë. (Vendimi Nr.prot.37/02/05/2019 dt.31.10.2019)
- Për mjetet që janë planifikuar për bashkë financim me Kuvendet Komunale (për ujësjellës dhe kanalizim), obligohet menaxhmenti të caktoj afatin e aplikimit dhe kriteret që duhet t’i përmbushin komunat për aplikim.(Vendimi nr.prot.37/05/05/2019 dt.31.10.2019)
- Rishikimi i Planit të Biznesit 2019 (Vendimi Nr.prot. 23/07/02/2019 dt.31.07.2019)
- Planin e Biznesit dhe Buxhetin Vjetor 2020-2022 (Vendim Nr.prot.37/06/05/2019 dt.31.10.2019)
- Vendimi mbi Ndryshimin dhe Plotësimin e Statutit të KRU “Hidrodrini“Sh. A. Pejë si vijon: Ndryshohet dhe plotësohet nenit 14 i Statutit të KRU “Hidrodrini” Sh.A.Pejë në harmoni me Vendimin e Republikës të Qeverisë së Kosovës Nr.09/107 të dt.18.06.2019 dhe obligon Kompaninë që të bëjë dorëzimin e njoftimit dhe dokumenteve tjera lidhur me këto ndryshime dhe plotësime në Agjencionin për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës.(Vendimi Nr.prot.23/08/02/2019 dt. 31.07.2019)
- Strukturën Organizative e KRU “ Hidrodrini “ Sh. A. Pejë - Modeli 2. (Vendimi Nr.Prot.23/06/02/2019 dt.31.07.2019)

- Kërkesën e menaxhmentit për të filluar procedurat për sigurimin shëndetësor vullnetar të punëtorëve të KRU “ Hidrodrini” Sh. A. Pejë dhe që për shpenzimet e pagesës së sigurimit shëndetësor vullnetar të participohet 50% KRU “Hidrodrini” Sh. A. dhe 50% nga të ardhurat mujore të punëtorit të siguruar.(Vendimi Nr.prot.37/07/05/2019 dt.31.10.2019)

Aktivitetet e Auditimit të Brendshëm

Raporti Vjetor i Zyrës së Auditimit të Brendshëm për vitin 2019 ,është përgatitur sipas detyrimeve që dalin nga Ligji mbi Ndërmarrjet Publike.

Zyra e Auditimit të Brendshëm në KRU "Hidrodrini" Sh.A gjatë vitit 2019 ka kryer Aktivitetet e Auditimit, sipas Planit Vjetor të Auditimit të Brendshëm për vitin 2019 , të aprovuar nga Komisioni i Auditimit. Plani vjetor është përgatitur sipas Planit Strategjik të aktiviteteve të auditimit të Brendshëm për periudhën kohore 2017-2019.

Gjatë vitit 2018 janë kryer auditimet sipas planit vjetor, nuk ka pasur auditime shtesë apo auditime me kërkesë nga Komisioni i Auditimit.

Komisioni i Auditimit gjatë vitit 2019, ka aprovuar Planin Vjetor të Auditimit të Brendshëm për vitin 2019 në mbledhjet e rregullta të Komisionit të Auditimit.

Tabela I :Aktivitetet e Auditimit të Brendshëm

Nr	Përshkrimi i Auditimit	Objektivat e Auditimit	Indeksi i rrezikut	Rekomandimet e dalta nga auditimet	Personeli i angazhuar në auditim
1.	Mbikqyrja e punës së komisioneve regjistruese për stoqet inventarin asetet dhe paranë e	Përcjellja e punës së komisioneve regjistruese .	2.00	2 rekomandime	1

	gatshme.				
2.	Shërbimi Teknik (menaxhimi i humbjeve të ujit).	Funksionimi dhe mbarëvajtja e punës të Shërbimit Teknik	3.00	3 rekomandime	1
3.	Menaxhimi i pasurive	Funksionimi dhe mbarëvajtja e punës së këtij shërbimi.	2.00	3 rekomandime	1
4.	Menaxhim i punës së njësitit të kontrollit (inspektoriat).	Funksionimi dhe mbarëvajtja e punës së këtij shërbimi .	2.00	3 rekomandime	1
5.	Teknologjia Informative.	Zbatimi i rregulloreve përkatëse.	2.00	3 rekomandime	1
6.	Auditimi i rregullores së	Kontrollimi i zbatueshmërisë së	3.00	2 rekomandime	1

	brendshme mbi përdorimin e automjeteve zyrtare.	rregullores së brendshme mbi përdorimin e automjeteve zyrtare.			
7.	Plani Strategjik për vitin 2020-2020 si dhe Plani Vjetor për vitin 2020.	Përgatitja e planit vjetor për vitin 2020.	1.00		1
8.	Monitorimi i zbatimit të rekomandimeve gjatë vitit 2019.	Përcjellja dhe monitorimi i zbatueshmërisë së rekomandimeve të dala gjatë vitit 2019.	3.00		1

Aktivitetet e Auditimit gjatë vitit 2019 janë realizuar sipas afateve kohore të parapara në Planin Vjetor të Auditimit të Brendshem.

o Pasqyra e performancës operative dhe financiare në krahasim me vitet paraprake dhe Plan të Biznesit

Vitet	2016	2017	2018	2019	Planifikuar 2019
Prodhimi (m³)	25,563,723	25,659,957	25,336,310	25,024,278	25,200,000
Faturimi (m³)	9.006.961	9.266.841	10.031.334	10,311,374	10,320,000


Humbjet (%)	65%	62%	60%	58.8%	59%
Shpenzimet (Euro)	2,285,876	2,448,283	2,501,846	2,549,860	2,616,000

Vitet	2016	2017	2018	2019	Planifikuar 2019
Faturimi (€)	3,537,082	3,644,856	3,754,879	3,937,043	3,840,000
Inkasimet (€)	2,764,127	2,912,768	3,224,363	3,681,587	3,360,000
Shkalle në %	78%	80%	86%	94%	88%
Norma e mbulesës së punës	1.23	1.21	1.30	1.47	1.29


Gjatë vitit 2019, inkasimi/arkëtimi është realizuar 110%, pra, me shumë se planifikimi, apo ne vlerë monetare me shumë për **321,587 euro**.

(Kemi një rritje konstante dhe stabile të inkasimit)

Faturimi sipas viteve



Arketimi sipas viteve



Norma e mbulesës së punës gjatë viteve 2016 - 2019:

2016.....(1.23),

2017.....(1.21),

2018.....(1.30),

2019.....(1.47).

Në Gjitha vitet është siguruar qëndrueshmëria.

(Ky është raporti në mes hyrave dhe shpenzimeve).

Humbjet ujit gjatë viteve:

Viti 2016.....65%,

Viti 2017.....62%,

Viti 2018.....60%.

Viti 2019.....58.7%.

o ***Një pasqyre e të priturve për vitin 2019.***

Gjatë vitit 2019, është planifikuar që shkalla e Arkëtimit të jetë si në tabelën e më poshtme.

Aktiviteti	Viti 2019	Planifikuar Viti 2019
Faturimi (€)	3,937,043	3,840,000
Inkasimet (€)	3,681,587	3,360,000
Shkalle në %	94%	88%
Norma mbulesës së punës	1.47	1.29
Uji i Pa faturuar %	58.7%	59%

Shenim:

Uji i pa futuruar sipas planifikimit eshte 59%, kurse ai i realizuar 58.7%, pra eshte sipas planifikimit.

Shpenzimet gjate vitit 2019, jane 2,549,860 euro, kurse te hyrat 3,681,587 euro, kemi mbulim te shpenzimeve dhe nje mbetje prej 1,131,727 euro.

• **Informacione lidhur me kapitalin dhe devidenten**

○ ***Kreditë e rëndësishme të nënshkruara apo paguara gjatë vitit***

Gjatë vitit 2019 nuk kemi pasur dhe as nuk kemi iniciuar ndonjë marrëveshje me institucionet financiare për huazim ose tërheqje te kredisë.

○ ***Investimet e rëndësishme të bëra gjatë vitit 2019***

Nga Donatoret:

1. Impianti i Trajtimit të Ujerave të Zeza në Pejë. Kosova IV. (duke u Implementuar),
2. Inqizimi dhe pastrimi i rrjetit të kanalizimit ne qytetin e Pejës, Kosova V. (duke u Implementuar),
3. Projekti i Implementimit te fazes VI, nga Zyra Zvicerane, Integrimi i fshatrave te cilan nuk jane në menaxhim nga Hidrodrini,
4. Implementimi i donacion nga Italianet, montimi i turbines per prodhimin e energjis elektrike ne Deçan.

Nga KRU"Hydrodrini"Sh. A. – Pejë:

1. Ndërtimi i stacionit të pompave në Banjë,
2. Ndertimi i rrjetit te kanalizimit ne Klinë,
3. Aktivizimi i rezervuarit te vjeter ne Pejë,
4. Furnizim me Ujematesa Shtepijak-mekanik,
5. Furnizim me Ujematesa shtepijak – digjital,
6. Ndertimi i zonave mbrojtese - Renovim i objekteve të klorinimit,
7. Furnizim dhe montim Garazhes për riparimin e automjeteve, konstrukcioni i parafabrikuar,
8. Ndertimi i rrjetit te ujesjellesit dhe kanalizimit ne Klinë (Ri-tender),
9. Ndertimi i rrjetit te Ujesjellesit,
10. Përgatitja e një strategjie për uljen e humbjeve të ujit dhe një program për reduktimin e humbjeve në rrjetin e KRU Hidrodrini,
11. Ndertimi i Rezervuarit të ri ne Banje ne rrjetin e ujesjellesit eksistues qe furnizon Banjen e Pejes me ujë.

o **Dividendët e paguara gjatë vitit 2019**

Meqenëse Kompania e Hidrodrinit për vitin 2019, ka një fitim prej 247,388 €, nga aksionari nuk është kërkuar që dividenda të paguhet.

• **Të dhëna për Drejtorët jo-ekzekutiv**

o **Bordi I Drejtorëve në KRU “ Hidrodrini “ Sh. A. Pejë ka këtë përbërje**

z Burim Basha	- kryesues
z Musë Mushkolaj	- anëtar
z Esad Abdullahi	- anëtar
z Skënder Veseli	- anëtar
z Rasim Mahmutoviq	- anëtar
z Sokol Boqolli	- anëtar

Bazuar në Vendimin e Nr.09/107 të dt.18.06.2019 të Qeverisë të Republikës së Kosovës, është përzgjedhur Bordi i ri Drejtorëve në KRU “Hidrodrini“ Sh. A. Pejë me këtë përbërje :

1. z. Demë Abazikryesues
2. z.Valon Haxhiaj.....anëtar
3. z.Vllaznim Përgjegjaj.....anëtar
4. z.Naim Tahiri.....anëtar
5. z.Musë Mushkolajanëtar
6. z.Nimon Zeneli.....anëtar

o **Kompensimet për paga të BtD për vitin 2019**

Nga data:(01.01.2019) deri me (18.06.2019)

z Burim Basha	- kryesues2,567.25€
z Musë Mushkolaj	- anëtar1,789.34€
z Esad Abdullahi	- anëtar1,730.08€
z Skënder Veseli	- anëtar2,149.60€
z Rasim Mahmutoviq	- anëtar1,644.34€

z Sokol Boqolli - anëtar2,413.04€

Nga data: (18.06.2019) deri me (31.12.2019)

z. Demë AbaziKryesues.....2,500.88€
 z.Valon Haxhijaj.....anëtar.....2,154.60€
 z.Vllaznim Përgjegjaj.....anëtar.....2,120.40€
 z.Naim Tahiri.....anëtar.....1,897.00€
 z.Musë Mushkolajanëtar.....1,897.00€
 z.Nimon Zeneli.....anëtar.....2,120.40€

- **Numri dhe pjesëmarrja e drejtorëve**
-
- **në takimet e rregullta të BtD, gjatë vitit 2019.**

KRU " Hidrodrini" Sh. A. Pejë				
Nr:	Mbledhjet e Bordit të Drejtorëve	Data	Ora	Personat prezent në mbledhje
1	E rregullt	31.01.2019	10,00	Bordi I Drejtorëve : z.B.Basha; z.S.Boqolli; z.R.Mahmutoviq; z.E.Abdullahi; z.S.Veseli; z.M.Mushkolaj z.A.Tigani; z.A.Ahmetaj dhe të ftuar tjerë
2	E rregullt	04.03.2019	10,00	Bordi I Drejtorëve : z.B.Basha; z.S.Boqolli; z.R.Mahmutoviq; z.S.Veseli z.E.Abdullahi;; z.M.Mushkolaj; z.A.Tigani – KE , z.Adem Ahmetaj si dhe të ftuar tjerë
3	E rregullt	29.03.2019	10,00	Bordi I Drejtorëve: z.B.Basha; z.S.Boqolli;; z.E.Abdullahi; z.S.Veseli; z.R.Mahmutoviq z.A.Tigani – KE dhe të ftuar tjerë.
4	E rregullt	26.04.2019	10,00	Bordi I Drejtorëve: z.B.Basha; z.S.Boqolli; z.R.Mahmutoviq; z.E.Abdullahi; z.S.Veseli; z.M.Mushkolaj; z.A.Tigani – KE dhe të ftuar tjerë
5	E rregullt	31.05.2019	10,00	Bordi I Drejtorëve : z.B.Basha;

				z.S.Boqolli; z.E.Abdullahi; z.S.Veseli; z.M.Mushkolaj; z.Rasim Mahmutoviq z.A.Tigani – KE dhe të ftuar tjerë
6	KVA	18.06.2019	10,00	Bordi I Drejtorëve : z.S.Boqolli; z.R.Mahmutoviq z.E.Abdullahi; z. S.Veseli; z.M.Mushkolaj; z.A.Tigani KE ; z.Arianit Ibrahim – Këshilltar i Drejtorit të NjPMNP, z.Adem Ahmetaj- analist në NjPMNP si dhe të ftuar tjerë.
7	E jashtëzakonshme	14.06.2019	10,00	Bordi I Drejtorëve : z.B.Basha, z.S.Boqolli, z.E.Abdullahi, z.S.Veseli, z.M.Mushkolaj, z.A.Tigani – KE dhe të ftuar tjerë
8	Konstituive	04.07.2019	14,00	Bordi I Drejtorëve : z.Demë Abazi, z.Valon Haxhij, z.Vllaznim Pergjegjaj, z.Nimon Zeneli, z.Musë Mushkolaj, z.Naim Tahiri dhe z.A.Tigani - KE dhe të ftuar tjerë
9	E rregullt	31.07.2019	14,30	Bordi I Drejtorëve : z.Demë Abazi, z.Valon Haxhij, z.Vllaznim Pergjegjaj, z.Nimon Zeneli, z.Musë Mushkolaj, z.Naim Tahiri dhe z.A.Tigani - KE dhe të ftuar tjerë
10	E rregullt	29.08.2019	12,00	Bordi I Drejtorëve : z.Demë Abazi, z.Valon Haxhij, z.Vllaznim Pergjegjaj, z.Nimon Zeneli, z.Musë Mushkolaj, z.Naim Tahiri, z.A.Tigani - KE dhe z.Adem Ahmetaj si dhe të ftuar tjerë.
11	E rregullt	04.10.2019	10,00	Bordi i Drejtorëve: z.Demë Abazi, z.Valon Haxhij, z.Naim Tahiri, z.Musë Mushkolaj, z.Nimon Zeneli dhe z.Agron Tigani dhe të ftuar tjerë
12	E rregullt	31.10.2019	12,00	Bordi I Drejtorëve : z.Demë Abazi, z.Valon Haxhij, z.Naim Tahiri, z.Musë Mushkolaj, z.Nimon Zeneli, z.Vllaznim Pergjegjaj dhe z.A.Tigani si dhe të ftuar tjerë.

13	E rregullt	31.12.2019	10,00	Bordi I Drejtorëve : z.Demë Abazi, z.Valon Haxhiaj, z.Naim Tahiri, z.Musë Mushkolaj, z.Nimon Zeneli, dhe z.A.Tigani si dhe të ftuar tjerë.
----	------------	------------	-------	--

- Në KRU “ Hidrodrini “ Sh. A. Pejë gjatë vitit 2019 Bordi i Drejtorëve ka mbajtur ____ (12) mbledhje të rregullta, KVA dhe 1 (një) mbledhje të jashtëzakonëshme.
- Bordi i Drejtorëve gjatë vitit 2019 ka operuar si një Bord unik dhe vendimet e marrura gjatë kësaj periudhe kanë qenë vendime të marrura me konsensus.

o Komisioni I Auditimit në KRU “Hidrodrini” Sh. A. Pejë ka këtë përbërje:

Bazuar në Vendimin e Ministrit të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik Nr.prot. 2768 të dt.23.11.2015, Komisioni i Auditimit në KRU “Hidrodrini” Sh. A. Pejë ka këtë përbërje:

1. Sokol Boqolli kryesues
- 2.Skënder Veseli..... anëtar
3. Musë Mushkolaj..... anëtar

Bazuar në Vendimin e Ministrit të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik Nr.prot. 1763 të dt.22.07.2019 është përzgjedhur Komisioni i r ii Auditimit në KRU “Hidrodrini” Sh. A. Pejë dhe ka këtë përbërje:

1. Valon Haxhiajkryesues
2. Vllaznim Pergjegjaj.....anëtar
3. Nimon Zenelianëtar

Mbledhjet e rregullta të Komisionit të Auditimit të mbajtura gjatë vitit 2019:

Nr:	Mbledhjet e Komisionit të Auditimit	Data	Ora	Personat prezent në mbledhje
1	E rregullt	25.01.2019	10,00	Komisioni I Auditimit: z.Sokol Boqolli, z.Skënder Veseli, z.Musë Mushkolaj dhe znj.Aurora Dinaj – ZAB si dhe të ftuar tjerë

2	E rregullt	26.02.2019	10,00	Komisioni I Auditimit : z.Sokol Boqolli, z.Skënder Veseli, z.Musë Mushkolaj dhe znj.Aurora Dinaj –ZAB si dhe të ftuar tjerë
3	E rregullt	26.03.2019	10,00	Komisioni I Auditimit : z.Sokol Boqolli, z.Skënder Veseli, z.Musë Mushkolaj znj.Aurora Dinaj – ZAB si dhe të ftuar tjerë
4	E rregullt	25.04.2019	10,00	Komisioni i Auditimit : z.Sokol Boqolli, z.Skënder Veseli, z.Musë Mushkolaj, znj.Aurora Dinaj - ZAB si dhe të ftuar tjerë
5	E rregullt	24.05.2019	10,00	Komisioni I Auditimit : z.Sokol Boqolli, z.Skënder Veseli, z.Musë Mushkolaj, znj.Aurora Dinaj –ZAB si dhe të ftuar tjerë
6	E rregullt	26.07.2019	11,00	Komisioni I Auditimit: z.Valon Haxhiaj - kryesues, z.Vllaznim Pergjegjaj, z.Nimon Zeneli-anëtarë znj.Aurora Dinaj -ZAB dhe të ftuar tjerë.
7	E rregullt	23.08.2019	11,00	Komisioni i Auditimit: z.Valon Haxhiaj - kryesues, z.Vllaznim Pergjegjaj, z.Nimon Zeneli – anëtarë, znj.Aurora Dinaj - ZAB dhe të ftuar tjerë.
8	E rregullt	26.09.2019	11,00	Komisioni i Auditimit : z.Valon Haxhiaj - kryesues, z.Vllaznim Pergjegjaj z.Nimon Zeneli - anëtarë dhe të ftuar tjerë.
9	E rregullt	24.10.2019	11,00	Komisioni i Auditimit : z.Valon Haxhia - kryesues, z.Vllaznim Pergjegjaj, z.Nimon Zeneli - anëtarë znj. Aurora Dinaj - ZAB dhe të ftuar tjerë
10	E rregullt	20.12.2019	10,00	Komisioni i Auditimit: z.Valon Haxhiaj- kryesues, z.Vllaznim Pergjegjaj, z.Nimon Zeneli - anëtarë znj. Aurora Dinaj - ZAB dhe të ftuar tjerë.

Bordi i Drejtoreve perveç komisionit të Auditimit nuk ka formuar asnje komitet duke pasur prasysh se pjeset e ketyre lemive i ka mbuluar BtD.

- **Informacione te tjera**

- ***Kërkesat për likuidimin e Ndërmarrjeve shoqërore për vitin 2019***

KRU "Hidrodrini" Sh. A.- Pejë, gjatë kësaj periudhe nuk ka pasur kërkesa të tilla.

- ***Informacione tjera, ashtu siç parashihet në LNP dhe statutin e NP-ve***

Informata për aksionarin:

- **Informacione lidhur me Asetet e Kompanisë:**

Në vitin 2018 vlera e aseteve neto është **19,559,286 €** kurse ne vitin 2019 është **24,814,371 €**

Numri I punëtorëve gjatë viteve nuk ka ndryshuar, caku I menaxhmentit është që stafi të trajnohet ashtu që të ritet efikasiteti në punë.

Efikasiteti I stafit gjatë vitit 2016..... **4.73,**

Efikasiteti I stafit gjatë vitit 2017..... **4.50,**

Efikasiteti I stafit gjatë vitit 2018..... **4.10,**

Efikasiteti I stafit gjatë vitit 2019..... **4.23.**

(Eshtë raporti i numrit te punëtorëve me konsumatorë, 1/1000)

3. RAPORTI I ZYRTARIT KRYESOR EKZEKUTIV

- **Ngjarjet kryesore të vitit 2019**

Janar – Mars 2019 - TM1

Gjatë TM1 – 2019, kemi kryer aktivitete në fushën e administrimit të procesverbaleve të mbledhjeve të Bordit të Drejtoreve dhe Komisionit të Auditimit, vendimeve të nxjerrura

nga mbledhjet, punë të ndryshme administrative dhe juridike, ka përfaqësuar Kompaninë në kontestet e natyrave të ndryshme në gjykata dhe dërgimin e propozimit për përmbarrim të borxhit për konsumatorët e papërgjegjshëm të Përmbarruesin Privat si dhe aktivitete për sigurinë dhe shëndetin në punë.

Bordi i Drejtorëve i KRU "Hidrodrini" Sh. A. Pejë ka mbajtur 3 (tri) mbledhje të rregullta : më dt. 31.01.2019, dt.04.03.2019 dhe dt.29.03.2019 , kurse Komisioni i Auditimit gjatë kësaj periudhe ka mbajtur 3 (tri) mbledhje të rregullta : më dt.25.01.2019 dt.26.02.2019 dhe dt.26.03.2019.

Duke u bazuar edhe në rekomandimet e Komisionit të Auditimit, gjatë kësaj periudhe Bordi i Drejtorëve me vota unanime i ka aprovuar këto dokumenta:

- Raportin Operativ dhe Financiar të KRU "Hidrodrini" Sh.A. Pejë për Dhjetor dhe TM4 – 2018 (Vendimi Nr.prot.03/01/01/2019)
- Raportin mbi realizimin e Planit të Biznesit sipas dinamikës në KRU " Hidrodrini "
 - o Sh. A. për Dhjetor dhe TM4 - 2018 (Vendimi Nr.prot.03/02/01.2019)
- Raportin mbi Kënaqshmërinë e Konsumatorëve të KRU " Hidrodrini " Sh. A. për
 - o TM4 - 2018 (Vendimi Nr.prot.03/03/01/2019)
- Raportin Operativ dhe Financiar të KRU "Hidrodrini" Sh.A. Pejë për Janar 2019 (Vendimi Nr.prot.06/01/02/2019)
- Pasqyrat Fianciare të KRU " Hidrodrini" Sh. A. Pejë për vitin 2018
 - o (Vendimi Nr.prot.6/02/02/2019)
- Raportin Vjetor të performancës të KRU " Hidrodrini" Sh. A. Pejë për vitin 2018. (Vendimi Nr.prot.6/03/02/2019)

Bordi i Drejtorëve në mbledhjen e rregullt të mbajtur më dt.04.03.2019 e shqyrtoi edhe çështjen së ndërtimit të hidrocentraleve në lumin Lumbardh të Pejës dhe nxori konkluzionin që :

- Bordi i Drejtorëve t'i drejtohet me një shkresë MZHE dhe institucioneve tjera relevante për shqetësimin që me realizimin e projektit për ndërtimin e hidrocentraleve në lumin Lumbardh të qytetit të Pejës, mund të rrezikohet furnizimi i banorëve me ujë të pijshëm, dëmtimi i rrjedhës së lumit dhe burimeve të ujit.

- Bordi i Drejtorëve në Shkresën Nr.prot.84 të dt.07.03.2019 ka shprehur shqetësimin e tij për propozimin e realizimit të projektit për ndërtimin e hidrocentraleve në lumin Lumbardh në qytetin e Pejës. Shkresa e cekur i është dërguar Kryeministrit të Republikës së Kosovës, Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Ministrisë së Trgëtisë dhe Indutrisë dhe Kuvendit Komunal - Pejë.

Kurse lidhur me Kërkesën Nr.prot.74 dt.27.02.2019 të parashtruar nga Separantum Choir për mundësin e përkrahjes financiare për të njëjtën nga KRU "Hidrodrini" Sh. A. Pejë, Bordi i Drejtorëve autorizoi KE që: Bazuar në Matricën e Autorizimeve Kryeshefi Ekzekutiv të ndaj një shumë të caktuar për përkrahje financiare të Siparantum Choir.

Në mbledhjen e rregullt të dt.29.03.2019 Bordi i Drejtorëve me vota unanime aprovoi :

- Raportin Operativ dhe Financiar i KRU "Hidrodrini" Sh. A. Pejë, për Shkurt- 2019, me sugjerimet e dhëna.
- Raportin Vjetor - Sondazh i Hulumtimit të Kënaqshmërisë së Konsumatorëve të KRU "Hidrodrini" Sh. A. Pejë, për vitin 2018, me vërejtjet e dhëna.

Konkluzionet:

- Menaxhmenti ekzekutiv për takimet e radhës të raportoj sipas sugjerimit të Komisionit të Auditimit që raporti të hartohet sipas raportimit të Kryeshefit Ekzekutiv dhe udhëheqësave të departamenteve, për aktivitetet kryesore që i kanë pas gjatë muajit.
- Obligohet menaxhmenti ekzekutiv që raportin e kualitetit të ujit t'ju dërgoj të gjithë kryetarëve të komunave të regjionit.
- Që për çdo aktivitet, që inicohet nga Zyra e Prokurimit, të raportohet data dhe procedurat e kryera deri më ditën e raportimit.
- Të bisedohet me menaxherat e NjO në lidhje me performancën për përmirësimin e rezultateve në NjO.
- Komunikimi me MMPH të jet në nivel dhe menaxhmenti të bëj përpjekje që puna për implementimin e Projektit për rehabilitimin e ujësjellësit në fshatin Strelc dhe kanalizimi për fshatin Irzniq të vazhdoj.

Pas shqyrtimit të Vetëvlerësimit të Bordit të Drejtorëve për vitin 2018, nxorri këtë konstatim:

- Që Bordi i Drejtorëve gjatë vitit 2018 ka operuar si një Bord unik dhe se vendimet e marrura gjatë kësaj periudhe kanë qenë vendime të marrura me konsensus, me vota unanime.

Dokumentat e aprovuara në mbledhjet e cekura më lartë janë përcjellur nga KRU “Hidrodrini” Sh. A. Pejë, në NjPMNP brenda afatit ligjor: Procesverbalet e mbledhjeve të Bordit të Drejtorëve dhe Komisionit të Auditimit, Raportet Operative dhe Financiare për Dhjetor dhe TM4 – 2018, Janar dhe Shkurt – 2019, Raporti mbi Kënaqshmërinë e Konsumatorëve TM4 – 2018, Raporti Vjetor i Performancës të KRU “Hidrodrini” Sh.A. Pejë për vitin 2018, shkresa e Bordit të Drejtorëve drejtuar Kryeministrit, MZHE, MMPH, MTI, Kuvendit Komunal të Pejës, Vetëvlerësimi i Bordit të Drejtorëve – 2018, Raporti Vjetor - Sondazh mbi hulumtimin e Kënaqshmërisë së Konsumatorëve të KRU “Hidrodrini” Sh. A. Pejë për vitin 2018.

Qeverisja Korporative Nr.prot.111 dt.27.03.2019- KRU “Hidrodrini” Sh. A. Pejë për vitin 2018 është përgatitur sipas Udhëzuesit të bashkangjitur në Kodin e Etikës dhe Qeverisjës Korporative të Ndërmarrjeve Publike dhe e njëjta është dorëzuar në NjPMNP brenda afatit ligjor.

Më dt.13.02.2019 sipas kërkesës së AKK kemi dërguar në mënyrë elektronike Listen e Zyrtarëve të Lartë të KRU“ Hidrodrini “ Sh.A. Pejë bazuar në Ligjin Nr 04/L-228 Për ndryshimin dhe plotësimin Ligjit Nr.04/L – 50 Mbi deklarinimin ,prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publik dhe prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë, që kanë obligim deklarimin vjetor të pasurisë.

Bazuar në nenin 8 të Ligjit Nr.04/L – 50 Mbi deklarimin prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publik dhe prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë,i kemi njoftuar ZL për obligimin e tyre për deklarimin vjetor te pasurisë duke nënshkruar edhe deklaratën për njoftim.

Më dt.30.01.2019, nga MZHE – NjPMNP është bërë kërkesë elektronike me qëllim që nga KRU “Hidrodrini“ Sh. A. Pejë të raportohet mbi numrin e kërkesave për qasje në dokumente publike të pranuar për TM4 – 2018.

Më dt.01.02.2019 nga ana e Shërbimit Juridik është dërguar në NjPMNP Raporti TM 4 – 2018 për kërkesat e pranuar për qasje në dokumente publike në KRU “ Hidrodrini “ Sh.A.Pejë

Më dt.20.03.2019 është bërë kërkesë elektronike nga MZHE – NjPMNP me qëllim që nga KRU “Hidrodrini “ Sh. A. Pejë të dërgohen dokumenta të caktuara për kompletimin e webfaqesë të MZHE.

Bazuar në nenin 37 paragrafi 37.4 të Ligjit Nr.03/L-087 mbi NP dhe kërkesën elektronike nga NjPMNP të dt.29.03.2019 janë dërguar në formë elektronike dokumentat e kërkuara për kompletimin e webfaqesë të MZHE-së me të dhëna për vitin 2018 të nënshkuara nga personat përgjegjës .

Prill – Qershor 2019 – TM2

Gjatë TM2 – 2019, në fushën e administrimit të procesverbaleve të mbledhjeve të Bordit të Drejtorëve dhe Komisionit të Auditimit, vendimeve të nxjerrura nga mbledhjet, punë të ndryshme administrative dhe juridike, ka përfaqësuar Kompaninë në në kontestet e natyrave të ndryshme në gjykata dhe dërgimin e propozimit për përmbarrim të borxhit për konsumatorët e papërgjegjshëm te Përmbarruesin Privat si dhe aktivitete për sigurinë dhe shëndetin në punë.

Bordi i Drejtorëve i KRU “Hidrodrini “Sh. A. Pejë ka mbajtur 3 (tri) mbledhje të rregullta : më dt.26.04.2019, dt.31.05.2019 dhe mbledhjen e jashtëzakonshme më dt.14.06.2019 si dhe MKVA dt.18.06.2019 , kurse Komisioni i Auditimit gjatë kësaj periudhe ka mbajtur mbledhje të rregullta : më dt.25.04.2019 dt.24.05.2019 .

Duke u bazuar edhe në rekomandimet e Komisionit të Auditimit, **Bordi I Drejtorëve në mbledhjen e rregullt të majtur më dt. 26.04.2019 me vota unanime i ka aprovuar këto dokumenta:**

- Raporti Operativ dhe Financiar i KRU “Hidrodrini” Sh. A. Pejë, për Mars dhe TM1–2019.
(Vendimi Nr. prot. 12/01/04/2019 dt.26.04.2019)
- Raporti mbi realizimin e Planit të Biznesit sipas dinamikës i KRU “ Hidrodrini “ Sh.A.Pejë, për TM1 – 2019 .(Vendimi Nr.prot.12/02/04/2019 dt.26.04.2019)
- Raporti mbi Kënaqshmërinë e Konsumatorëve të KRU “ Hidrodrini” Sh. A. Pejë për TM1 – 2019. (Vendimi nr.prot.12/03/04/2019 dt.26.04.2019).
- Raporti i Auditorit të Jashtëm për Pasqyrat Financiare të KRU “Hidrodrini” Sh. A. Pejë, për periudhën 01.01.2018 – 31.12.2018 dhe Letër Menaxhmenti. (Vendimi nr.prot.12/04/04/2019 dt.26/04.2019)
- Vlerësimi i performances së menaxhmentit të KRU “Hidrodrini“ Sh. A. Pejë gjatë vitit 2018.

Në mbledhjen e jashtëzakonëshme të dt.14.06.2019 Bordi I Drejtorëve me shumicë votash ka marrë vendim:

- Aprovohet në parim Skema Organizative KRU “Hidrodrini” Sh. A. Pejë, me sugjerimet e dhëna për korrigjim (modeli 2).
- Obligohet menaxhmenti që t’l zbatoj sugjerimet e Bordit të Drejtorëve dhe të plotësoj Skemën Organizative me emërtime adekuate dhe për çdo pozitë të shënohet numri i ekzekutuesve. (Vendimi Nr.prot.19/01/2019 dt.14.06.2019)

Në mbledhjen e Kuvendit Vjetor të Akcionarit të mbajtur më dt.18.06.2019 me vota unanime janë aprovuar :

- Raporti i Auditorit të Jashtëm për Pasqyrat Financiare të KRU “Hidrodrini” Sh. A. për vitin 2018.
- Letër Menaxhmenti i Auditorit të Jashtëm. (Vendimi Nr.prot.18/01/2019 dt.18.06.2019)
- Aprovohet Raporti Vjetor i Performancës i KRU “ Hidrodrini” Sh. A. Pejë, për vitin 2018. (Vendimi Nr.prot.18/02/2019 dt.18.06.2019)
- Aprovohet Vlerësimi i Performances së Menaxhmentit nga ana e Bordit të Drejtorëve me Nr.prot. 187 të dt: 27.05.2019 (Vendimi Nr.prot.18/03/2019) dt.18.06.2019)

Më dt.24.06.2019 nga Drejtori I NjPMNP jemi njoftuar me Vendimin Nr. 9/107 të dt.18.06.2019 për përzgjedhjen e Bordit të Ri të Drejtorëve në KRU “ Hidrodrini” Sh. A. Pejë, në këtë përbërje:

1. Demë Abazi - kryesues
2. Valon Haxhijaj - anëtar
3. Villaznim Përgjegjaj - anëtar
4. Naim Tahiri - anëtar
5. Musë Mushkolaj - anëtar
6. Nimon Zeneli - anëtar

Dokumentat e aprovuara në mbledhjet e cekura më lartë janë përcjellur nga KRU “Hidrodrini” Sh. A. Pejë, në NjPMNP brenda afatit ligjor: Procesverbalet e mbledhjeve të Bordit të Drejtorëve dhe Komisionit të Auditimit, Raportet Operative dhe Financiare, Raporti mbi Kënaqshmërinë e Konsumatorëve , Raporti Vjetor i Performancës të KRU “Hidrodrini” Sh.A. Pejë për vitin 2018,

Vlerësimi I Performancës së menaxhmentit, Raporti I Auditorit të Jashtëm per Pasqyrat Financiare – 2018 dhe Letër Menaxhmenti.

Korrik – Shtator 2019 – TM3

- Raporti Operativ dhe Financiar i KRU “Hidrodrini” Sh. A. Pejë për muajin Maj-2019. (Vendimi Nr.prot.23/02/02/2019 dt.31.07.2019)
- Raporti Operativ dhe Financiar i KRU “Hidrodrini” Sh. A. Pejë për Qershor dhe TM2– 2019, me sugjerimet e dhëna. (Vendimi Nr.prot.23/03/02 /2019 dt.31.07.2019)
- Raporti i realizimit të Planit të Biznesit sipas dinamikës të KRU “ Hidrodrini” Sh. A. Pejë, për TM2 – 2019. (Vendimi Nr.prot.23/05/02/2019 dt.31.07.2019)
- Raporti mbi Kënaqshmërinë e Konsumatorëve të KRU “Hidrodrini” Sh.A.Pejë për TM2-2019.(Vendimi Nr.prot.23/06/02/2019 dt.31.07.2019)

- Që Plani i Biznesit 2019 i KRU “Hidrodrini” Sh. A. të mbetet sipas parametrave të planifikuara dhe se rishikimi i tyre është i panevojshëm.(Vendimi Nr.prot.23/07/02/2019 dt.31.07.2019)

- Vendimi mbi Ndryshimin dhe Plotësimin e Statutit të KRU “Hidrodrini” Sh. A. Pejë si vijon:

Ndryshohet dhe plotësohet nenit 14 i Statutit të KRU “Hidrodrini” Sh.A.Pejë në harmoni me Vendimin e Republikës të Qeverisë së Kosovës Nr.09/107 të dt.18.06.2019.

KRU “Hidrodrini” Sh.A. Pejë obligohet të bëjë dorëzimin e njoftimit dhe dokumenteve tjera lidhur me këto ndryshime dhe plotësime në Agjencionin për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës. (Vendimi Nr.prot.23/06/02/2019 dt.31.07.2019)

- Struktura Organizative e KRU “ Hidrodrini “ Sh. A. Pejë (Modeli 2), (Vendimi Nr.prot. 23/06/02/2019 dt.31.07.2019)
- Kërkesa Nr.prot.425 dt.08.08.2019 e parashtruar nga ana e Kryeshefit Ekzekutiv të Kompanisë që me rastin e Festës së Bajramit të Vogël të gjithë punëtorëve të KRU “ Hidrodrini “ Sh. A. Pejë të ju ndahen mjete financiare në vlerë bruto prej 50 € për secilin punëtor, të cilat mjete do të shpërndahen në llogarinë bankare të secilit punëtor. (Vendimi Nr.prot.27/2019 dt.08.08.2019)
- Autorizohet Zyrtari i Lartë Financiar që t’i drejtohet Bankës Qendrore të Kosovës me një kërkesë me shkrim për lejimin e pagesës së faturave me *e-banking* për konsumatorët e KRU “Hidrodrini” Sh. A. Pejë. (Vendimi Nr.prot.37/02/05/2019 dt.29.08.2019)
- Raporti i KE për aktivitetet operative dhe financiare të KRU “Hidrodrini” Sh. A. Pejë për Korrik – 2019, me sugjerimet e dhëna.(Vendimi Nr.prot. 31/01/ 03/2019 dt.29.08.2019)

- Aprovohet në parim Kërkesa nga Ministria e Punës dhe Mirëqenjes sociale- Zyra për punësim në Pejë. Obligohet Kryeshefi Ekzekutiv që Kërkesën e cekur më lartë t’ia përcjell Bordit të Drejtorëve. (Vendimi Nr.prot. 31/04/03/2019 dt.29.08.2019)
- Aprovohet Deklarata për Politikën e Kompenzimit të drejtorëve dhe zyrtarëve të lartë të KRU “ Hidrodrini” Sh.A. Pejë për vitin 2018, me plotësime dhe korrigjime të rekomanduara nga z.Adem Ahmetaj:
 1. Deklarata për politikën e kompenzimit të drejtorëve dhe zyrtarëve të lartë të KRU “Hidrodrini” Sh. A. Pejë për vitin 2018 të ekzekutohet pas vlerësimit të performances së Bordit të Drejtorëve nga Akcionari.
 2. Menaxhmenti t’i drejtohet NjPMNP me një kërkesë për sqarim lidhur me ekzekutimin e kësaj Deklarate duke ia bashkangjitur të dhënat për performancën e KRU“ Hidrodrini” Sh. A. Pejë për vitin 2018. (Vendimi Nr.prot.31/03/03/2019 dt.29.08.2019)

Tetor– Dhjetor 2019 – TM4

- Raporti i KE për aktivitetet operative dhe financiare të KRU “Hidrodrini” Sh. A. Pejë për Gusht - 2019, me sugjerimet e dhëna (Vendimi Nr.prot 34/01/04/2019 dt.04.10.2019)
- Raporti i Kryeshefit Ekzekutiv për aktivitetet operative dhe financiare për Shtator dhe TM3 – 2019 të KRU “Hidrodrini” Sh.A.Pejë, me sugjerimet e dhëna. (Vendimi Nr.prot.37/01/05/2019 dt.31.10.2019)
- Aprovohet Raporti i realizimit të Planit të Biznesit sipas dinamikës në KRU “Hidrodrini” Sh. A. Pejë, për TM3-2019. (Vendimi Nr.prot.37/03/05/2019 dt.31.10.2019)
- Aprovohet Raporti mbi Kënaqshmërinë e Konsumatorëve të KRU “ Hidrodrini” Sh.A. Pejë, për TM3-2019. (Vendimi Nr.prot. 37/04/05/2019 dt.31.10.2019)
- Për mjetet që janë planifikuar për bashkë financim me Kuvendet Komunale (për ujësjellës dhe kanalizim), obligohet menaxhmenti të caktoj afatin e aplikimit dhe kriteret që duhet t’i përmbushin komunat për aplikim.(Vendimi Nr.prot. 37/05/05/2019 dt.31.10.2019)
- Aprovohet Plani i Biznesit dhe Buxheti Vjetor i KRU “Hidrodrini” Sh.A. Pejë për periudhën 2020-2022, me sugjerimet për korrigjim dhe plotësim. (Vendimi Nr.prot.37/06/05/2019 dt.31.10.2019)

- Aprovohet kërkesa e menaxhmentit për të filluar procedurat për sigurimin shëndetësor vullnetar të punëtorëve të KRU “ Hidrodrini” Sh. A. Pejë.
- Për shpenzimet e pagesës së sigurimit shëndetësor vullnetar të participohet 50% KRU“ Hidrodrini” Sh. A. dhe 50% nga të ardhurat mujore të punëtorit të siguruar.(Vendimi Nr.prot. 37/07/05/2019 dt.31.10.2019)
- Aprovohet Raporti i Kryeshefit Ekzekutiv për aktivitetet operative dhe financiare për Tetor dhe Nëntor - 2019 të KRU “Hidrodrini” Sh.A.Pejë, me sugjerimet e dhëna.(Vendimi Nr. prot. 40/01/06/2019 dt. 31.12.2019)
- Aprovohet Kërkesa e Kryeshefit Ekzekutiv të Kompanisë që me rastin e Festës së Vitit të Ri të gjithë punëtorëve të KRU “Hidrodrini“ Sh. A. Pejë të ju ndahen mjete financiare në vlerë bruto prej 100 € për secilin punëtor, të cilat mjete do të shpërndahen bashkë me pagën e muajit Dhjetor - 2019. (Vendimi Nr.prot.02/06/2019 dt.31.12.2019)

• **Pasqyrën e performances operative dhe financiare si dhe rezultatet e indikatorëve kyç të performances**

○ ***Prodhimi i ujit***

KRU"Hidrodrini"Sh.A. - 2019			
Totali			
	Prodhimi mes. ditor	Prodhimi mujor	Prodhimi mesatar
	m ³	m ³	l/s
Janar	68,145	2,112,508	789
Shkurt	67,363	2,088,268	780
Mars	67,794	2,101,607	785
Prill	67,042	2,078,304	776
Maj	67,056	2,078,733	776
Qershor	67,093	2,079,885	777
Korrik	67,151	2,081,671	777
Gusht	67,339	2,087,518	779
Shtator	67,380	2,088,772	780
Tetor	66,960	2,075,760	775
Nëntor	66,957	2,075,653	775
Dhjetor	67,095	2,079,938	777
MES.	67,281	2,085,718	779

o **Kualiteti i ujit**

Kualiteti i Ujitë - KRU"Hydrodrini"	Viti 2016	Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019
Totali i Testeve të realizuara	2,597	2,385	2.532	1.920
- Që nuk janë në pajtim me standardet	0.16	0	0	0
- % (keq)	0%	0%	0%	0%

o **Ankesat te zgjedhura**

Treguesi	Aktiviteti	Totali
Ankesat Teknike te pranuar, Ujesjelles	Nr. Total	4.665
	Të shqyrtuara dhe të zgjedhura me kohë	4.665
Ankesat Teknike te pranuar, Kanalizim		985
	Të shqyrtuara dhe të zgjedhura me kohë	985
Ankesat komerciale te pranuar	Nr. Total	121
	Të shqyrtuara dhe të zgjedhura me kohë	121

o **Çështjet Ligjore**

Gjatë vitit 2019 janë mbajtur 8 Seanca - 4 Seanca Gjyqësore dhe 4 Seanca në Prokurorin e Shtetit në Pejë.

- Seanca Gjyqësore.lidhur me Lëndën.C.nr.67/110 çështja (vertetim pronësie) ne Gjykatën Themelore ne Klinë

- Seanca Gjyqësore ne Gjykatën Themelore ne Prishtinë ne Departamentin për Çështje Ekonomike lidhur me lenden V.EK.47/17 , çështja (kompenzim dëmi)
- Katër Seanca ne Prokurinë Themelore në Pejë, për kyqje ilegale.
 - 2 - Raste kanë përfunduar me ndermjetesim ku eshte bere marreveshja për ta paguar borxhin, 2 – Raste e kanë refuzuar ndërmjetësimin (marrëveshjen) dhe ndaj tyre është ngritur Aktakuza
- Seancë Gjyqësore e mbajtur me 02.12.2019 në Gjykatën Themelore në Istog.

P.nr.252/19, ndaj të paditurit Hysen Sefaj. Çështja (Kyqje Ilegale)

Ndaj të paditurit së pari ishte Shqiptuar Kallëzim Penal në Prokurorinë Themelore në Pejë, e cila pas intervistimit të dyshuarit i kishte ofruar ndërmjetësim me anë të ndërmjetësuesit. Ku kërkonte nga ai kompenzimin e dëmit të cilin ja kishte shkaktuar Hidrodrinit. Por i dyshuari kishte refuzuar ndërmjetësimin dhe pas refuzimit daj tij ishte ngritur aktakuze ku lenda ka kaluar në Gjykatën Themelore në Istog. Gjatë mbajtjes së Seancës Gjyqësore ne si Kompani Hidrodrini i kishim ofruar fakte dhe prova Gjykatës nga te cilat në Shpalljen e Akgjykimit përfundimtar i dyshuari Hysen Sefaj ishte shpallur fajtor për veprën vjedhje e shërbimëve nga neni 314 par 1 KPRK. Dhe ishte dënuar me 300 euro gjobë

